



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2018:015067

Datë: 19.02.2019

Numri i dokumentit: 00228396

P.nr.325/2016

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË, Gjyqtari i vetëm gjykues Qemail Suka, me bash. Professional Feim Bytyqi, në çështjen penale kundër të akuzuarit D. S. nga Prizreni, për shkak të veprës penale blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 pa. 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, sipas aktakuzës së Prokurorisë të shtetit në Prizren, PP.II.nr.2715/14, të datës 21.04.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, në prani të Pokurorit të Shtetit Besim Susuri, të akuzuarit dhe të dëmtuarit Sh. M., me datë 06.02.2019 mori dhe publikisht shpalli dhe me date 15.02.2019 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

D. S., nga i ati Sh. dhe e ëma K. S. e lindur L., i lindur me 08.09.1993, në Prizren, rr.”F.” nr...., ku edhe tani jeton, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pamartuar, i gjendjes së dobët ekonomike, gjendet në vuajtje të dënimit për veprat tjera penale në Qendrën e Paraburgimit në Prizren, me numër personal .

ËSHTË FAJTOR

Sepse në rrugën e q. në Prizren, nga një person i panjohur, ka blerë sendin – telefonin e përfituar me vepër penale “I. 5” me numër të IMEI: me numrë të Ipkosë 0./...-.... pronë e të dëmtuarit Sh. M. nga fshati Gj. Komuna Suharekë, të cilin e ka aktivizuar me numrin e valës 0./...-.... nga data 14.07.2014.

-këso dore ka kryer veprën penale blerja pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 par. 1 të KP-së.

Andaj, gjykata në kuptim të nenit 7, 41, 43 al.1 pika 1.3, 49 al. 1 pika 1.1, 50, 51, 52, 73, 74, 75, 76 dhe 345 par.1 të KPK-së, dhe nenit 359 par. 1 dhe 2 dhe neni 365 të KPP-së, i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Ashtu që i vërteton **dënimin me burg prej 4 (katër) muajve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin e verifikimit prej 1 (një) viti nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij

aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepra tjera penale, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Obligohet i akuzuari që në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguaj shumën prej 30 euro si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 20 euro, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP.II.nr.2715/14, të datës 21.04.2016, kundër të akuzuarit D. S. nga Prizreni, për shkak të veprës penale vjedhja nga neni 325 par. 1 të KP-së.

Në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me datë 06.02.2019 prokurori i shtetit e ka rikualifikuar veprën penale dhe ka kërkuar që i akuzuari të dënohet për veprën penale blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 par. 1 i KPK-së.

Prokurori i shtetit Besim Susuri, në fjalën e tij përfundimtare deklaron: se për veprën penale blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 paragrafi 1 i KPK-së, i pandehuri të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

I akuzuari në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se: nuk ka qenë në dijeni se sendin që e ka blerë, ka qenë send i vjedhur, është penduar dhe zotuar se vepra të tilla në të ardhmën nuk do të përsërisë.

Gjykata në shqyrtimin gjyqësor ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Se me datë 23.06.2014, rreth orës 17:20 min., në fshatin G. Komuna Suharekë, në pishinën e quajtur "F.", të dëmtuarit Sh. M., i është marr çanta e dorës në të cilën kishte: një (një) telefon i markës "I. 5", me ngjyrë të bardhë me numër të Ipkos-s 0./...-..., 1 (një) orë dore e markës "A.", çelësat e automjetit, letërnjoftimin, patentë shoferin, kartelën e bankës dhe ID – kartelën e U. të P., të gjitha në vlerë rreth 585 (pesëqind e pesëdhjetë e pesë), për të cilën është akuzuar i akuzuari D. S..

Gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk u provua se i akuzuari ka vjedhur nga i dëmtuari çantën e dorës me gjësendet tjera, të cituar si më lart, por se tek i akuzuari është gjetur "I. 5" i të dëmtuarit, të cilin i akuzuari ka sqaruar se e ka blerë nga një person në rrugën e q. në Prizren, dhe për të njëjtin ka kuptuar se është i vjedhur vetëm atëherë kur e ka thirr policia.

Në bazë të gjendjes së re faktike të vërtetuar gjatë shqyrtimit gjyqësor, prokurori i shtetit e ka rikualifikuar akuzën ndaj të akuzuarit dhe ka kërkuar nga gjykata që të njëjtin ta shpallë fajtor për veprën penale blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 par.1 të KPK-së dhe ta dënoj sipas ligjit.

I dëmtuari Sh. M. ka deklaruar se nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk parashtron kërkesë pasurore juridike.

I akuzuari nuk e ka kundërshtuar rikualifikimin e akuzës dhe ka theksuar se nuk ka qenë në dijeni se sendi ka qenë i vjedhur nga personi që e ka blerë, ka shprehë pendesë dhe është zotuar se vepra të tilla në të ardhmën nuk do t'i përsërisë.

Gjykata gjendjen e këtyre faktike e ka vërtetuar nga deklaratat e të dëmtuarit e dhënë në stacionin policor në Suharekë me dt.23 dhe 24.06.2014, deklaratat e të pandehurit e dhënë në

stacionin policor në Suharekë me dt.13.10.2014 si dhe shkresat e lëndës dhe ate njoftimi i kompanisë ligjore Ipko 9..-2 dt.04.07.2014, informacioni i zyrës ligjore të kompanisë vala me numër ZKL nr.2.../14 dt.18.09.2014 dhe formulari i pronës së dt.23.06.2014.

Gjykata gjendjen faktike e ka vërtetuar edhe nga provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor nga të cilat në mënyrë bindëse u konstatua se i akuzuari e ka blerë sendin – telefonin e përfituar me vepër penale “I. 5” me numër të IMEI: me numër të Ipkosë 0./...-... pronë e të dëmtuarit Sh. M. nga fshati Gj. Komuna Suharekë nga një person i panjohur në rrugën e q. në Prizren, të njëjtin e ka aktivizuar me numrin e kompanisë vala 0./...-... nga data 14.07.2014, gjykata ka ardhur në përfundim, se këto fakte janë provuar në tërësi si të bazuara, andaj në veprimet e akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 paragrafi 1 të KPK-së, paraprakisht duke vërtetuar përgjegjësinë e tij penalo juridike.

Me rastin e marrjes të vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KP të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke mos gjetur rrethana rënduese, e që si rrethanë lehtësuese është marrë sjellja korrekte e të akuzuarit gjatë shqyrtimit gjyqësor, gjykata vlerësoi rrethanat personale dhe karakterin e të akuzuarit, moshën e të akuzuarit, bashkëpunimin e përgjithshëm të akuzuarit me gjykatën, si dhe sjelljen korrekte të tij gjatë shqyrtimit ku është penduar dhe zotuar se nuk do të përsërisë vepra të tilla në të ardhmën, andaj gjykata i shqiptoi dënimin me kusht dhe ate dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin e verifikimit prej 1 (një) viti nga dita e plotëfuqishëmrisë të këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë të tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jetë më i kujdesshëm dhe do të përmbahet nga veprimet e tilla.

Vendimin mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim të nenit 450 dhe 451 të KPP-së.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË
P.nr.325/16 të dt. 15.02.2019

Bashk. profesional
Feim Bytyqi

Gjyqtari
Qemal Suka

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur mund të ushtrojë ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 dite nga dita e pranimit, ankesa dorëzohet nëpërmjet të kësaj gjykate.